

STATUTI DHE AKTI THEMELIMIT
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"M&M Group"

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

a. Sot në Tiranë në datën 27 Nentor 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegësi të kufizuar e emërtuar "M&M Group" shpk, me vullnet shoqërítë tregtare. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "M&M Group" shpk, formohet nga ortaku themelues:

Migailed Delija shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.07.1984, lindur në Tirane, banues në Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID I40714078J.

b. I cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregëtare", si dhe Aktin e Themelimit, ka vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tij, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "M&M Group" SHPK, fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

Neni 2

- Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Emërtimi i Shoqërisë është: "M&M Group" SHPK.
- Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQËRISË


Neni 3

- Shoqëria tregtare "M&M Group" SHPK, ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë me adresë, Rruga Deshmoret e Fekinit, Nr. 52/3, 1023, Njesia Bashkiale Nr. 7, Tirane - AL.
- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.
- Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KOHËZGJATJA

Neni 4

- Shoqëria Tregtare "M&M Group" SHPK, do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
- Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i Shoqerisë "M&M Group" SHPK do të jetë: import & export dhe tregëtimi me shumice e pakicë i kafes apo produkteve dhe nën produkteve të tjera që kanë lidhje me kafenë, importimi dhe tregëtimi i aparaturave dhe makinerive të ndryshme që përdoren në këtë fushë si psh. ekspresa, mulli, etj. Servisimi dhe mirembajtje e paisjeve të ndryshme që kanë lidhje me kafen si eksresa për bare, eksresa të vegjël për zyra apo përdorim familjar, mulli etj.

TË DREJTAT E SHOQËRISË

Neni 6

Shoqëria tregtare "M&M Group" SHPK., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko – tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin, sipas vendimeve që do të marrin ortakët e saj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë (Njeqind mijë lekë), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është në një (1) kuotë, vlerë nominale 100,000 lekë (Njeqind mijë lekë) Kapitali themeltar zotërohet nga:

1. Migailed Delija - zotërues i 1 (një) kuote apo 100% të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku ka të drejtë të tjetërsoje, të zmadhoje apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji Kapitali fillestare nuk është paguar.

Neni 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.

Neni 9

1. Përbërja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithëshme të shoqerisë dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

Neni 10

1. Shoqëria Tregetare "M&M Group" SHPK., është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në perputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

Neni 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqërisë do të mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitiit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakëve të saj.

Neni 12

Pjesët e kapitalit themeltar nuk janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato nuk janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

Neni 13

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbytjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

Neni 14

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakëve.



Neni 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqerise mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTË

ORTAKËRIA

Neni 16

Ortakët e shoqërisë tregtare "M&M Group " SHPK., gjëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve

Neni 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e illogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU I TRETË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të Shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator.
Migaile Delija i cili përfaqëson Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjeter, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

ASAMBLEJA

Neni 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

Neni 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë:

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të Shoqërisë;
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e Shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e Shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e Shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e Shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjeter që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të Shoqërisë dhe Statuti i saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e Shoqërisë.

BAZA LIGJORE

Neni 27

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të Shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

Neni 31

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje originale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKËT:

Z. Migailed Delija

Migailed Delija

